**“Ardhmëria e bisedimeve të Beogradit dhe Prishtinës pas ngjarjeve më të reja në veriun e Kosovës”. -10.11.2011**

**Moderatori:** Ju dëshiroj të gjithëve një ditë të mirë dhe mirëserdhët në Qendrën Mediale në Çagllavicë. Debatin e sotëm me temën “Ardhmëria e bisedimeve të Beogradit dhe Prishtinës pas ngjarjeve më të reja në veriun e Kosovës” e ka organizuar ekipi i Qendrës Mediale me mbështetjen e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur nga Prishtina. Një mirëseardhje të veçantë iu dëshiroj panelistëve tanë e ata janë: Petar Milletiq-nën-kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe Sekretar i përgjithshëm i SLS-së, partisë e cila merr pjesë në pushtet; Adrijana Hoxhiq-shefe e ekipit përgatitor për decentralizimin e komunës së veriut të Mitrovicës dhe Azem Vllasi, analist, ish-politikan dhe këshilltar i Qeverisë së Kosovës. Në veçanti i falënderoj panelistët që kanë ndarë kohën e tyre ashtu që sot të jenë me ne. Për debatin e sotëm ka qenë i paralajmëruar edhe Goran Arsiq, kryetar i rrethit drejtues të Kosovës para Qeverisë së Serbisë, por ai mbrëmë e anuloi pjesëmarrjen duke thënë se duhet urgjentisht të shkojë në një mbledhje në Beograd. Natyrisht, nuk kemi arsye të dyshojmë në këtë. Ndoshta kjo temë edhe nuk është interesante dhe aq e rëndësishme pas ngjarjeve të mbrëmshme ku erdhi deri te vdekja e njërit dhe plagosja e dy të rinjve tjerë, e ndoshta është pikërisht tash koha të hapim këtë temë për dialogun dhe të përpiqemi që në një mënyrë të pengojmë ndodhi të këtilla. Në fillim të dëgjojmë përfaqësuesin e pushtetit, z. Petar Milletiq. Z. Milletiq na thoni se a ka ardhmëri dialogu i Beogradit dhe Prishtinës dhe a munden ngjarjet më të reja në veriun e Kosovës të ngadalësojnë apo edhe shtyjnë këtë dialog apo madje edhe plotësisht ta ndërpresin?

**Petar Milletiq**: Ju faleminderit për ftesën dhe unë i përshëndes të gjithë të pranishmit. Unë mendoj se dialogu veçse është ngadalësuar nga 25 korriku e deri më tani, mendoj se negociatat do të thoja se madje janë ndalur dhe me të vërtetë keni të drejtë kur në hyrje thatë që sot është tejet vështirë të flitet për çfarëdo teme tjetër kur është humbur një jetë e re në veriun e Kosovës. E shfrytëzoj këtë rast ta dënoj këtë incident, të dënoj vrasjen dhe plagosjen e njerëzve që jetojnë në veri dhe kjo vetëm tregon që një zgjidhje e këtillë është e paqëndrueshme. Për mua zgjidhja më e keqe është ajo ku ndodh që njerëzit të humbin jetën e tyre. Kjo vetëm po tregon se dialogu me të vërtetë ka rënë në krizë, kurse që dialogu ka ardhmëri unë jam i bindur për këtë, unë mendoj se ai nuk ka alternativë dhe ne si parti politike edhe po përpiqemi për zgjidhjen e problemeve që do të zgjidhen me dialog. Më duket se situata ka ngecur në dy qëndrime ashpërsisht të kundërshtueshme dhe që qartazi ende nuk kemi ardhur deri tek ideja se si ta zgjidhim situatën në veri të Kosovës. Ajo çka mendoj unë është që ajo situatë edhe nuk mund të zgjidhet pa pjesëmarrjen e katër faktorëve më të rëndësishëm në Kosovë, e ata janë: Prishtina, Beogradi, bashkësia ndërkombëtare dhe serbët lokal. Pa njërin nga këta katër faktorë në procesin e zgjidhjes së problemit nuk do të ketë sukses apo unë nuk besoj në atë sukses. Natyrisht, ne në Kuvendin e Kosovës si parti politike e kemi mbështetur procesin e dialogut të Beogradit dhe Prishtinës dhe jemi kritikuar atëherë nga shumë bashkëkombës tanë, të cilët nuk e kanë ditur që dialogu duhet të fillojë të jap ndonjë

rezultat. Pas pjesëve të para, do të thosha relativisht të suksesshme të dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës që e kanë udhëhequr znj. Edita Tahiri dhe z. Borko Stefanoviq, po them,më 25 korrik ai dialog, thënë më së buti, është ngadalësuar, dhe tani së paku presim të fillojë implementimi i atyre pjesëve që deri më tani janë dakorduar. Ne presim edhe vazhdimin e dialogut dhe natyrisht se duhet të bisedohet edhe për veriun. A do të jetë kjo në kuadër të atyre bisedimeve në Bruksel apo si të them do të gjenden disa bisedime tjera për veriun, gjithsesi është e domosdoshme që diçka e tillë të fillojë që të ndërpritet kjo që po ndodh në veri e kjo është që njerëzit po i humbin jetët e tyre. Kjo është për mua disi çështja më prioritare dhe ja për fund të them që unë jam dëgjuar me njerëzit nga Qendra Mediale, madje iu kam propozuar që të mos flasim sot për këtë temë në këtë atmosferë siç është tani, por mirë, pasi që njerëzit e kishin caktuar paraprakisht, unë pranova të vijë dhe të përgjigjem në pyetjet tuaja. Faleminderit.

Ju faleminderit zoti Milletiq. Zoti Vllasi, ju mund të flisni këtu si analist, mundeni edhe si jurist, e më përmirësoni nëse jam gabimisht e informuar, ju jeni edhe këshilltar në Qeverinë e Kosovës. Na thuani,  çka e këshilloni ju sot Qeverinë e Kosovës, a të vazhdohet dialogu me Beogradin apo jo?

**Azem Vllasi**: Pikërisht për këtë dua t'ju them diçka. Shpresoj se keni përkthim si zakonisht sepse ju këtu jeni të organizuar mjaft mirë. Do të kombinojmë sepse për mua nuk është vështirë të flas edhe në gjuhë serbe. Dialogu është në Evropë dhe për tërë botën e civilizuar një mjet i pazëvendësueshëm  për zgjidhjen e problemeve. Ky është një parim të cilin duhet gjithmonë ta respektojmë kur flasim për zgjidhjen e problemeve. Kjo ka të bëjë edhe me problemet që lidhen me Kosovën dhe Serbinë. Sa i përket situatës momentale, unë, ashtu të them, do të kisha disa këshilla, për palën kosovare, palën serbe, si dhe për serbët e Kosovës. Për palën kosovare, këshilla ime kryesore do të ishte që pjesëmarrësit në dialog dhe zonja Tahiri t'i mos gëzohen shumë vazhdimit të dialogut të ardhshëm të Beogradit dhe Prishtinës sepse nga ato biseda nuk ka ndonjë dobi thelbësore për palën kosovare. Vendimi që pala kosovare është e gatshme të vazhdojë dialogun pa kurrfarë dobie e dobëson pozitën e saj, madje ndikon edhe në humbjen e dinjitetit. Në këtë mënyrë, bashkëbiseduesit tjetër, d.m.th palës serbe i jepni arsye të mendoj se ju keni ndonjë arsye që po ju ngutet kurse palës tjetër nuk po i ngutet. Kjo do të ishte këshilla palën tonë kosovare. Këshilla ime për palën e Beogradit do të ishte që nëse hyjnë në bisedime sinqerisht dhe me dëshirë që me të vërtetë të zgjidhen disa, siç po i quajnë probleme praktike që i kanë qytetarët e Serbisë dhe Kosovës, atëherë le të vazhdojnë bisedimet sinqerisht por duke mos kombinuar në njërën anë serbët e Kosovës në barrikada me vazhdimin e bisedimeve. Bashkëbiseduesi i palës serbe Borisllav Stefanoviq, një ditë merr pjesë në bisedimet në Bruksel e  pastaj një javë është në barrikadat në veri të Kosovës. Kështu nuk shkon. Mendoj se pala serbe duhet të nxjerr disa mësime nga e kaluara. Është e rrezikshme të luhet me njerëz nëpër rrugë dhe në barrikada. Dje pashë se kishte pasur disa eksese e sot po shoh se dikush është vrarë. Prandaj po them se kjo është mënyrë tejet e rrezikshme e shfrytëzimit të njerëzve për qëllime politike. Pse thashë mësime nga e

kaluara? Ne e dimë që Millosheviqi para njëzet e ca viteve i tha serbëve të Kosovës të dalin në mitingje dhe të lëshojnë institucionet e Kosovës sepse Kosovën do ta boj Serbi. E dimë se si kaloi ajo politikë. Tani Tadiqi dhe Qeveria e tij po i mbështesin serbët dhe po u thonë të dalin në barrikada sepse ashtu do të fitojnë bile një pjesë të Kosovës, d.m.th do të marrin pjesën veriore. Dëmi kolateral i një politike të tillë janë qytetarët e Kosovës, do të thotë serbët. Unë si njeri që mbaj mend më gjatë dhe që jam ballafaquar me situata politike të ngjashme, më vjen keq që qytetarët serbë të një pjesë të Kosovës po keqpërdoren për qëllime politike të Serbisë. Serbia mendon që kështu o të përmirësojë pozitën e vet negociuese ndaj iniciativave diplomatike kundër Kosovës. Kjo është e gabueshme. Porosia e fundit dhe mendimi im se si duhet të vazhdohet dialogu është porosia për serbët e Kosovës në pjesën veriore. Serbët e pjesës veriore duhet të fillojnë dialogun me institucionet e Kosovës në të cilën do të bëjnë kërkesa legjitime. Në këtë dialog ata duhet të paraqesin problemet dhe brengat e tyre. Askush nuk kërkon prej tyre që të vijnë dhe të thonë se e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës, por le të adresojnë problemet dhe shqetësimet e tyre ndaj institucioneve kosovare. Kështu dë të sjellin institucionet e Kosovës në pozitë që të marrin përgjegjësinë e jo që Qeveria e Kosovës të shikojë se çka po bën KFOR-i dhe se a mundet ndonjë polic i EULEX-it të shkojë në veri apo jo. Porosia e fundit është për institucionet e Kosovës. Porosia ime kryesore është që ata duhet të gjejnë një mënyrë dhe të bien në kontakt me serbët e pjesës veriore të Kosovës. I kemi njerëzit në institucione, e kemi Sllobodan Petroviqin, në Parlamentin e Kosovës e kemi zotin Milletiq e të tjerë. Natyrisht duhet edhe shqiptarët e jo vetë ata të hyjnë në dialog me serbët e asaj pjese të Kosovës. Nëse ne, d.m.th institucionet kosovare, presim se çka do të bëjë KFOR-i atje dhe se a do ta heq rërën me lopata, kjo kështu nuk shkon. Kjo do të ishte porosia dhe mendimi im se si duhet të debllokohet situata dhe si duhet të vazhdohen bisedimet me Serbinë në Bruksel.

**Moderatori**: Adrijana Hoxhiq është shefe e ekipit përgatitor për decentralizimin e komunës së Mitrovicës së veriut. Supozoj se ka kontakte edhe me ekipin e Prishtinës për bisedime me Beogradin dhe që u jep këshilla të caktuara. Këtë do të na e thotë ajo vetë. Urdhëroni, zonjusha Hoxhiq.

**Adrijana Hoxhiq**: Ju faleminderit para së gjithash për ftesën dhe dua të përshëndes të gjithë të pranishmit këtu. Unë do të shfrytëzoj këtë rast që së pari shkurtimisht t'ju tregoj të gjithë juve për aktivitetet e ekipit përgatitor komunal. Ekipi përgatitor komunal është në të vërtetë  një ekip teknik i cili praktikisht merret me përgatitjen e krijimit të kushteve për formimin e komunës së re, Mitrovicës së veriut. Në parim, ne jemi në kontakte të përditshme me komunitetin në veri. Po përpiqemi që së bashku me komunitetin në veri të zbulojmë se cilat janë problemet e përditshmërisë, po përpiqemi që së bashku të vijmë deri tek idetë me të cilat do të mund të zgjidhim probleme të caktuara që gjenden në terren. Si rezultat i këtij bashkëpunimi të përbashkët, ne kemi identifikuar shumë projekte në veri, të cilat ia kemi arritur t'i implementojmë së bashku me komunitetin. Natyrisht me mbështetje domethënëse të donatorëve tanë, midis të tjerëve USAID-it.

Sa i përket vetë dialogut, midis aktorëve politik, unë mendoj se kjo është në të vërtetë gjëja e vërtetë dhe që ngjarjet e djeshme janë në të vërtetë një argument më tepër për vazhdimin e atij dialogu. Ka nevojë për dialog të sinqertë, dhe është koha e fundit që të shohim rezultatet e tërë atyre dialogjeve. Mendoj se kjo është diçka që do të inkurajoj komunitetin që të vazhdojë të përpiqet dhe të mbetet në këto hapësira. Mirëpo, mendoj se në tërë këtë situatë kemi hapësirë për disa dialogje tjera, jo vetëm për këtë që po ndodh midis Beogradit dhe Prishtinës. Për shembull, është tejet e nevojshme të bëhet një dialog direkt midis Qeverisë së Kosovës dhe komunitetit që jeton në veri. Me vetë këtë, konsideroj që kjo sigurisht do të jap kontribut në krijimi e besimit të ndërsjellë. Konsideroj që qytetarët në veri të Kosovës janë ngopur me tërë këtë situatë, njerëzit kanë dëshirë të vazhdojnë të jetojnë dhe të funksionojnë normalisht, të merren me problemet e tyre të përditshme dhe asesi nuk iu intereson politika. Porosia ime për liderët politik është se është koha e fundit që të fillojnë të sillen dhe të veprojnë përgjegjshëm ashtu që me të vërtetë t'iu dalin në ndihmë qytetarëve të veriut të Kosovës. Ju faleminderit shumë.

**Moderatori:** Faleminderit. Urdhëroni me pyetjet.

**Radio Dukagjini**: Si e vlerësoni dialogun e gjertanishëm midis Kosovës dhe Serbisë dhe a duhet në atë dialog të diskutohet edhe për veriun e Kosovës? A është ky qëndrim i Kuvendit të Kosovës dhe sipas të gjitha gjasave qëndrim i partisë suaj politike?

**Petar Milletiq**: Unë e përmenda dialogun për ardhmërinë e veriut të Kosovës si mundësi. Pra, ne e dimë që në dialogun që po ndodh, me ndërmjetësimin e Unionit Evropian, nuk është paraparë tema e veriut. Në ato tema që na janë prezantuar, nuk është parashikuar biseda për veriun e Kosovës. E dimë që është folur për kadastrën, librat amzë, lirinë e lëvizjes, diplomat universitare, por veriu nuk ka qenë temë. Unë nuk e përjashtoj mundësinë që në kuadër të këtij dialogu të flitet edhe për veriun e Kosovës. Mua personalisht kjo nuk do të më pengonte, por nëse kjo do të ngarkonte këtë dialog teknik, siç po quhet, nëse kjo do të ngarkonte çështjen e këtyre problemeve të përditshme për të cilët po flasin Borko Stefanoviq dhe Edita Tahiri, ndoshta do të kishte qenë më mirë të organizohet një dialog i veçantë vetëm me temën e veriut të Kosovës. Kjo është vetëm një ide. Mendoj se kemi ngecur dhe mendoj se duhet menduar diçka të re ashtu që po e përsëris, njerëzit të mos humbin jetët e tyre.

**Radio Kim**: E kam një pyetje për të gjithë pjesëmarrësit. A jeni ju të gatshëm, si përfaqësues të institucioneve dhe organizatave, të shkoni në veri dhe të vizitoni familjen e serbit të vrarë dhe në këtë mënyrë simbolikisht të tregoni se duhet të ndërpritet me këtë?

**Petar Milletiq**: Natyrisht që jam i gatshëm dhe që kjo pyejt nuk duhet fare të bëhet. Unë mendoj se ne sot po flasim për atë se si të parandalojmë që këto gjëra të tilla të mos ndodhin më. Nuk e di a do ta kishte më lehtë familja e të vrarit kur unë do t'i shprehja ngushëllime. Unë ja tani publikisht po iu shpreh ngushëllime dhe kjo nuk është

kontestuese. Po e përsëris, duhet të gjenden mënyra që gjëra të tilla të mos ndodhin më.

**Azem Vllasi**: Sa më përket mua, unë së pari si jurist do të bëj përpjekje që të hetohen të gjitha rrethanat në të cilat njeriu ka humbur jetën e atëherë ajo njerëzorja, natyrisht që duhet të shkohet dhe të vizitohet familja sepse kjo është një gjë humane dhe njerëzore. Por, më e rëndësishmja është që duhet të shikohen rrethanat ashtu që këto gjëra të mos përsëriten.

**Adrijana Hoxhiq**: Si përfaqësuese e ekipit komunal përgatitor e gjykoj fuqishëm një akt të tillë që ka ndodhut në veriun e Mitrovicës dhe shprehim keqardhje për një akt të tillë dhe natyrisht ngushëllime të sinqerta për familjen. Ne jemi të gatshëm të vizitojmë familjen. Dua të nënvizoj që kjo që ka ndodhur dje paraqet një argument më tepër që është e domosdoshme të vendoset sundimi i ligjit i cili nuk ekziston në veri. Ajo që ndodhi dje është pasojë e mosekzistimit të sundimit të ligjit në veri. Pajtohem me zotin Vllasi se duhet të hetohen të gjitha në të cilat ka ndodhur ajo që ka ndodhur dje dhe kujt e tërë kjo i shkon për shtati.

**Ekspres**: Zoti Milletiq e përmendi mundësinë që ky dialog të jetë i pasuksesshëm. Kryeministri Thaçi ka përmendur mundësinë që Kosova dhe Serbia të ulen dhe të bisedojnë në nivelin më të lartë ashtu që të vihet deri te marrëveshja e cila do të sjell paqë midis dy vendeve. Sa është e mundshme që në të ardhmen të ulen këta dy njerëz, kryesuesit e Kosovës dhe Serbisë ashtu që të vijë deri te marrëveshja? Dialogu i tanishëm teknik po bëhet në nivel të ulët, si nga ana e Serbisë ashtu edhe nga ana e Kosovës. Në Kosovë nuk ka kush të vendos për këtë dialog. A prisni ju së shpjeti që të ulen zoti Thaçi dhe zoti Tadiq dhe të arrijnë deri tek një lloj marrëveshjeje ashtu që të zgjidhin probleme të caktuara?

**Petar Milletiq**: Unë sinqerisht besoj në këtë. A do të jenë ata Tadiq dhe Thaçi apo dy liderë tjerë nuk e di por sinqerisht besoj që dy liderë do të ulen dhe do të bisedojnë për temat më të mëdha. Dialogu teknik ka filluar ashtu që Beogradi ka deleguar z. Stefanoviq e Prishtina znj. Tahiri, por unë gjithsesi them që do të vijë momenti kur këta dy liderë që i përmendët apo dikush tjetër do të ulen dhe do të bisedojnë. E dimë që zgjedhjet po vijnë dhe liderët ndryshojnë por unë vesoj që do të duhet të ulen një ditë dhe të zgjidhin edhe ato problemet më të mëdha. Nëse menduat në temën e veriut kur thatë që ekziston mundësia që bisedimet të jenë të pasuksesshme, unë nuk besoj që mund të gjendet zgjidhje politike derisa janë barrikadat në rrugë. Hapi i parë drejt vendosjes së dialogut politik duhet të jetë largimi i barrikadave. Unë mendoj se largimi i barrikadave është i mundur dhe i drejtë vetëm nëse është vullnetar, që të mos largohen me dhunë, që ato t'i largojnë ata që i kanë vendosur. Që kjo të ndodh, duhet të bisedohet seriozisht me ata njerëz që i kanë vendosur dhe të shihet se çka po i motivon ata që ditenatë të jenë në barrikada. Besoj se as ata nuk e kanë lehtë të jenë në barrikada në këtë kohë të ftohtë, nuk është lehtë t'i lënë familjet e tyre dhe punët e të kujdestarojnë atje.

**Blue sky**: Z. Milletiq, a besoni ju që pas atyre barrikadave qëndron Beogradi siç po mendohet këtu në Kosovë? E dimë që ekziston një obligim pune për banorët e atjeshëm dhe ndoshta në një mënyrë ata janë të detyruar të jenë në ato barrikada edhepse ata ndoshta nuk e duan këtë. A është zgjidhja tek Beogradi?

**Petar Milletiq**: Unë me të vërtetë nuk dua të spekuloj se kush krejt e organizon at atje dhe a kanë njerëzit obligim pune apo shkojnë vullnetarisht. Unë mendoj se kjo është periferike. Zgjidhja është tek Beogradi, por jo vetëm tek Beogradi. Unë e thashë në fillim që secili prej nesh e ka një pjesë të asaj torte të përgjegjësis, kështu që edhe Beogradi e ka pjesën e vet. Por, edhe Prishtina e ka pjesën e vet të përgjegjësisë. Bashkësia ndërkombëtare, e cila e ka marr përsipër menaxhimin e krizës në veri, konkretisht KFOR-i dhe EULEX-i, të gjithë e kanë pjesën e vet të përgjegjësisë. Pra, të gjithë ne që marrim pjesë në jetën publike e kemi pjesën tonë të përgjegjësisë dhe unë nuk do t'ia hidhja përgjegjësinë vetëm njërës palë, qoftë kur është fjala për Beogradin, Prishtinën apo bashkësinë ndërkombëtare.

**Azem Vllasi**: Më duhet të them diçka për këtë. Pajtohem plotësisht me shpjegimin e z. Milletiq, por më duhet të shtoj diçka. Nuk ka kurrfarë dyshimi që pas barrikadave qëndron Beogradi, pushteti në Beograd. Por tani problemi qëndron aty se pushteti ka nxitur që politika të udhëhiqet me barrikada e tani partitë opozitare në Serbi e kanë marr komandën mbi komandantët dhe pushtetin, Goran Bogdanoviq dhe ky Stefanoviqi janë zënë në habi. Më falni, por të udhëhiqet politika  me barrikada dhe t'iu nxihet jeta atyre njerëzve atje është... më falni por...nuk është e mirë.

**Radio Dukagjini**: Me sa e kuptova, sipas fjalëve të z. Milletiq, është aq keq sa duhet të fillojë një dialog i ri për veriun. Si duhet të fillohet sipas jush, si e shihni ju konceptualisht këtë dialog, në çfarë përbërej?

**Azem Vllasi**: Unë do të bëja një krahasim. Ju kujtohet se në vitin 2001 ishte një krizë në jug të Serbisë, në Luginën e Preshevës, me shqiptarë të armatosur, kryengritës. Serbia e sanoi disi atë krizë pa dialog me neve kosovarët, në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare. Unë do të propozoja një skenar të ngjashëm. Qetësimi i gjendjes në veri të Kosovës, dhe kur flitet për dialog, unë mendoj, që të mos them ekskluzivisht, që varet nga bisedimet e Qeverisë sonë me qytetarët tanë kosovarë në veri të Kosovës. Nuk mund të bëhet dialog në trekëndësh, pushteti i Serbisë, pushteti i Kosovës dhe serbët lokal. Qeveria e Beogradit nuk çan kokën shumë se si do të zgjidhet problemi dhe se si t'iu mundësohet qytetarëve të atjeshëm të mos vuajnë porse se si të instrumentalizohet ai problem dhe se si të shfrytëzohet ajo pjesë e qytetarëve serbë për qëllime vetanake e kundër Kosovës. Unë jam i qartë, dialog po, por dialog i pushtetit tonë drejtpërdrejtë me qytetarët e vet. Serbët e Leposaviqit janë qytetarë të Kosovës.

**Radio Dukagjini**: Ata liderë me të cilët duhet të bisedohet në veri për Kosovën janë struktura paralele dhe ilegale dhe ajo nuk do të bisedojë me ta. Si mundeni ju ta

mendoni një dialog me serbët e atjeshëm kur ata vendosin barrikada dhe kur janë të dirigjuar nga Beogradi dhe kur Qeveria e Kosovës atje nuk ka autoritet?

**Azem Vllasi**: Unë nuk mendova në ata që veten e quajnë liderë. Mua gjithherë më imponohen disa krahasime. Atëherë kur organizoheshin mitingjet për destabilizimin e Kosovës, ka pasur të ashtuquajturr liderë. Kanë pasur emra të ndryshëm, njëfarë Sholleviq, Kosta Bullatoviq e shumë të tjerë. Ne atëherë nuk kemi bërë dialog me ta sepse e kemi ditur kush janë ata dhe çka duan të bëjnë. Kjo është dukuri e zakonshme. Kur njerëzit e rëndomtë dhe qytetarët e rëndomtë dikush i bind që është i rëndësishëm dhe e she veten nëpër barrikada çdo mbrëmje në televizion, ata mendojnë se janë të rëndësishëm e në të vërtetë nuk janë. Unë besoj që ka serbë në veriun e Kosovës me të cilët mund të bëhet dialog si me qytetarë kosovarë. Pushteti në çdo shtet ka obligime që të komunikojë me qytetarët në territorin e vet dhe të gjejë zgjidhje për probleme. Mos kërkoni prej meje të shkruajë ndonjë recetë, por le të emërohet një grup njerëzish, a është Ylber Hysa apo dikush tjetër dhe dikush nga serbët ashtu që të ulen dhe të bisedojnë. Ata serbë që janë për bisedime duhet të emërohen nuk duhet t'i quajmë tradhtarë. Unë mendoj se njerëz të tillë ka, sigurisht ka.

**Forum**: Z. Milletiq, thatë se barrikadat duhet të hiqen vullnetarisht. Serbët nga veriu i Kosovës thonë që nuk do të bëjnë këtë. Sa do të pres Qeveria e Kosovës që barrikadat të hiqen në atë mënyrë?

**Petar Milletiq**: Unë nuk mendoj se duhet të pritet por duhet të veprohet, por mendoj se duhet të veprohet me këtë fryt të civilizuar të cilin e quajmë dialog. Heqja e barrikadave me forcë nuk është zgjidhje e qëndrueshme. Është e qartë për të gjithë që ato barrikada nuk mundet sot as KFOR-i t'i heq me forcë. Unë besoj që ata kanë shumë më tepër fuqi se sa që do të kishte policia speciale e Kosovës, ROSU. Ata mund ta bëjnë këtë, por unë besoj që diplomatët që mendojnë për këtë e dinë që kjo nuk është zgjidhje e qëndrueshme. Edhe nëse barrikadat hiqen me forcë, çka nesër, çka pasnesër, çka nëse hiqen disa e vendosen të tjera, çka nëse fillojnë konflikte të përmasave më të gjera? Unë jam kundër kësaj. Mendoj se duhet të veprohet por që duhet të vendoset kontakt me këta njerëz që e kanë organizuar atë protestë në formë të barrikadave dhe të shihet se cilat janë kërkesat e tyre e pastaj me shkathtësinë e negociatave të arrihet tek një zgjidhje mesatare.

**Forum**: Por kërkesat janë të njohura. Kërkesat janë që në Jarinje dhe Bërnjak të mos ketë doganierë kosovarë. Kjo është e qartë për të gjithë ne.

**Petar Milletiq**: Unë e di që këto janë kërkesat. Unë vetëm po pyes se kush ka biseduar deri më tani me ata njerëz? A e di dikush me siguri që ata nuk do të heqin dorë nga kërkesa të tilla, e që kjo të mos jetë zgjidhje që e kërkon Prishtina? Unë besoj që ekzistojnë zgjidhje mesatare. Unë mendoj se kjo është rrugëdalja.

**Forum**: A keni biseduar ju apo dikush prej jush?

**Petar Milletiq**: Jo.

**Forum**: Paj si atëherë po prisni zgjidhje?

**Petar Milletiq**: Ju thashë se si po e pres zgjidhjen. Këtë duhet ta nisin të gjithë ata që kanë përgjegjësi për këtë situatë, edhe Beogradi, edhe Prishtina, edhe bashkësia ndërkombëtare, serbët lokal. Nuk mundet asnjë prej nesh individualisht ta zgjidh këtë.

**Forum**: Cila është ajo zgjidhje?

**Petar Milletiq**: Mendoni tani t'ua jap zgjidhjen? Nuk e kam atë.

**Azem Vllasi**: Unë do të shtoja edhe diçka në këtë. A po ju duket kjo kërkesa që në këto dy kalime kufitare nuk mund të vijnë doganierë shqiptarë pak si racizëm? Çka do të ndodhte sikur shqiptarët , duke marr parasysh numrin e tyre atje në Luginën e Preshevës, te Bujanovci, të merrnin disa eskavatorë dhe të zënë rrugën me barrikada? Çka do të ndodhte po të digjnin punktet në pjesën serbe të kufirit dhe nëse do të thonin se nuk duan të shohin asnjë doganierë serbë? A do të mund dikush t'i thoshte  pushtetit në Beograd se kjo është një kërkesë demokratike? Unë kur kaloj andej shoh edhe doganierë dhe policë kufitarë edhe serbë edhe shqiptarë sepse atje ka shqiptarë. Prandaj, kjo nuk është çështja kryesore. Si të zgjidhet kjo kërkesë? Ajo kërkesë është absurde. Nuk munden njerëzit lokal t'i thonë shtetit ku duan apo nuk duan të shohin doganierë. Do ta them edhe një fjali. Tani një këshillë për ne, pikërisht i lidhur me këtë çështje. Unë e këshilloj Qeverinë, ata më falënderohen mirë, diçka pranojnë diçka jo, por kjo nuk është e rëndësishme. Po të isha unë negociator në palën kosovare do të bëja një kërkesë të qartë. Ose të normalizohet situata në të gjitha kalimet kufitare që janë evidentuar ndërkombëtarisht ose nuk do të funksionojë asnjë vendkalim kufitar për qarkullim të mallrave me Serbinë. Rampa e cila u lëshua në Merdar dhe në vendlindjen time nuk solli asgjë të re. Malli vjen nga Serbia e ajo organizon cirk në veri të Kosovës. Unë nuk do ta lejoja këtë. Është e qartë se Serbia atje ka një ndikim të madh dhe për këtë unë do të thoja ose të gjitha vendkalimet të funksionojnë normalisht ose asnjëri e të shohim. Ju lutem, Ky nuk është kurrfarë qëndrimi kundër-serb. Nëse Serbia thotë se nuk e pranon dhe se për të nuk ekziston shteti i Kosovës, nuk mundet kjo kështu. Ose ta marrim parasysh ose jo, kështu që Serbia nëse nuk do nuk ka nevojë edhe njëqind vjet ta njoh Kosovën. Por nëse do të shes mallrat e veta këtu ose të funksionojnë të gjitha vendkalimet ose asnjëri. Ose do të jenë të gjitha vendkalimet normale ose nuk duhet të jenë asnjëri.

**Moderatorja**: Zoti Vllasi, a mos po thirreni ju në izolimin e Kosovës?

**Azem Vllasi**: Nuk po thirrem unë asesi në izolimin e Kosovës. Pse në izolimin e Kosovës?

**Moderatorja**: Nëse e mbyllim kufirin?

**Azem Vllasi**: Jo, vetëm ta mbyllim kufirin për qarkullim të mallrave. Kosova është gjatë tërë kësaj kohe kufiri më i hapur n Evropë dhe sa i përket raportit me Serbinë është mjaft liberale. Nga Serbia qytetarët mund të hyjnë me letërnjoftime, dokumente të udhëtimit, tabela të Serbisë, malli me vula doganore dhe unë nuk po shoh asgjë të keqe në këtë. Përkundrazi, mendoj se kjo është në rregull. Kështu duhet të jetë. Por kështu duhet të jetë edhe në kuptimin e anasjelltë. Ky është ai reciprociteti. Prandaj unë nuk jam për kurrfarë mbyllje të Kosovës, por jam për respektimin e parimit të reciprocitetit. Ata tanët që flasin për reciprocitetin, unë e kam kuptuar se disa as nuk e dinë se çka do të thotë termi reciprocitet.

**Radio Dukagjini**: Diçka të tillë e ka përmendur edhe Ministri i Serbisë i punëve të brendshme, Ivica Daçiq, i cili tha që nëse vazhdohet me moshyrjen e mallit serb, atëherë Serbia do të shqyrtojë mundësinë e mbylljes së kufirit nga Presheva. Këtë që po e thuani ju, si mund të funksionojë kjo?

**Azem Vllasi**: Kërcënimi i Daçiqit ka qenë që do të dënojë qytetarët serbë të nacionalitetit shqiptar në jug të Serbisë, do të thotë t'iu krijojë probleme në qarkullim me Kosovën, jo neve, sepse neve edhe ashtu kemi mjaft probleme. Me dokumente Kosovës dhe targa të regjistrimit nuk mund të hysh në Serbi. Me mall, po thonë se është zgjidhur çështja e vulave doganore, do të thotë kjo nuk është zgjidhur. Ky është kërcënimi i Daçiqit qytetarëve, shtetasve të Serbisë të nacionalitetit shqiptar. Në Kosovë unë nuk po shoh se dikush po i kërcënon serbët, qytetarët tanë dhe unë këtë problem dhe deklaratë të Daçiqit do ta paraqisja në OKB. Tani Serbia do të bëj probleme për shtetasit e saj të nacionalitetit shqiptar, pse Kosova po kërkon masat e reciprocitetit. Kosova nuk ka kërkuar asgjë tjetër pos masat e reciprocitetit. Reciprociteti, për ata që nuk e dinë do të thotë në mënyrë të barabartë, ti mua unë ty dhe anasjelltas dhe asgjë që nuk është e lejuar për mua nuk do të lejohet as ty nga ana ime.

**Zëri i Amerikës**: Një pyetje për të gjithë pjesëmarrësit. A ka ndryshuar diçka në jetën tuaj, respektivisht në jetën e njerëzve dhe komuniteteve prej nga vini që nga fillimi i dialogut të Beogradit dhe Prishtinës? Kaluan 8 apo 9 muaj prej kur filloi dialogu, kemi pasur 6-7 raunde negociatash, çka ndryshoi?

**Azem Vllasi**: Në jetën time asgjë nuk ka ndryshuar.

**Petar Milletiq**: As në jetën time nuk ka ndryshuar gjë.

**Adrijana Hoxhiq**: Meqenëse unë jetoj në Mitrovicën e Kosovës, mendoj se në të vërtetë pak gjëra pozitive kanë ndodhur dhe ekzistimi i barrikadave e rëndom tejet shumë jetën normale. Unë me të vërtetë nuk po shoh ndonjë zgjidhje konkrete që vie si propozim as nga njëra as nga pala tjetër, mendoj në Beogradin dhe Prishtinën. Më dëshpëron fakti që shumë pak po konsultohen vetë qytetarët që jeton në veri. Njerëzit që jetojnë në veri, përmes bisedave të përditshme që i kam me ta janë tejet të zhgënjyer me këtë fakt. Është lehtë që njerëzit që jetojnë në rrugën "Knez Mihajlo" në Beograd apo disa në vetë qendrën e Prishtinës të flasin për njëfarë dialogu, të japin

dofarë propozimesh të cilat në fund askush nuk i respekton. Kjo nuk është zgjidhje, kjo është vetëm vazhdim i agonisë dhe ky qëndrim nuk shpie askund. Situata, sido që ë jetë, për qytetarët në veri të Mitrovicës nuk është e mirë.

**Zëri i Amerikës**: Ja edhe një pyetje pasi u përgjegjët shkurt. Çka mendoni, a do të ndryshojë diçka në jetën tonë nëse vie deri te ndërprerja e atij dialogu? Kemi pasur rastin të dëgjojmë para disa ditësh zonjën Edita Tahiri e cila thotë që ekziston kjo mundësi, pra kah shpie tërë kjo?

**Azem Vllasi**: Nëse vie deri te ndërprerja e dialogut, meqenëse ai edhe filloi si hutueshëm dhe se nuk dihet se kah po shpie, asgjë domethënëse nuk do të ndryshojë në jetën tonë. Prandaj, pasi që e fillova fjalën time ashtu, dialogu në Evropë dhe në këtë botën normale demokratike është mjeti themelor për zgjidhjen e problemeve. Duhet të caktohen disa parime në baza të shëndosha dhe e kam dhënë këtë këshillë, askush nuk më dëgjoi. Le të shohim se për cilat baza do të bisedojmë dhe aty është dashur të thuhet në bazë të reciprocitetit nën numrin një e pastaj vijmë deri tek çështjet konkrete. E është filluar mbrapshtë, nga çështjet praktike, e pastaj të shohim se ku do të vijmë. Cili është qëllimi i bisedimeve për çështje praktike, përmirësimi i standardit jetësor të qytetarëve. Do të thotë, liria e lëvizjes, për këtë është menduar në rend të parë, më falni por çka kemi fituar ne nga kjo? Çfarë lirie të lëvizjes ndaj Serbisë kanë qytetarët e Kosovës, shqiptarët, pasi që në disa media në Beograd thonë serbët dhe të tjerët joshqiptarë. Shqiptarë të tjerë jo serbët. Nuk shoh asgjë nga ndërprerja e këtij dialogu, kështu  të hutuar, i padefinuar, pa qëllim, e do të ulen palët që t'iu ndihmojë një Kuper më i mençur që të definohen bazat për bisedime.

**Petar Milletiq**: Pasi që ishit të pakënaqur me përgjegjjen e shkurtër, ende nuk ka ndryshuar gjë. Dhe unë mendoj se do të ishte dëm i madh nëse bisedimet ndërprehen kështu si janë, sepse unë mendoj se megjithatë janë arritur disa rezultate, ajo që ende nuk ka filluar të implementohet ajo për të cilën është dakorduar, kjo është një çështje tjetër dhe afati për fillimin e implementimit të atyre marrëveshjeve që janë arritur deri më tani ka qenë një nëntori. Unë nuk e di, d.m.th ende nuk e kam informatën që ka filluar me implementim, mendoj se jo, por ja kjo liria e lëvizjes dhe ajo që njerëzit me letërnjoftimet e Kosovës do të mund të lëvizin më lirshëm mendoj se është progres. Është progres nëse qytetari i Prishtinës, Prizrenit apo Pejës do të mund të marr çertifikatën nga libri kadastrës apo libri amzë e që të mos ketë nevojë të shkojë atje ku janë zhvendosur ato libra. Ky është progres. Po ashtu që njerëzit do të mund të ngasin veturat e tyre me targat KS është po ashtu një përparim. A mjafton kjo? Natyrisht se jo. A duhet të inkurajohen negociuesit kryesorë? Edhe kjo duhet. A është Kuperi ndërmjetësues sa duhet i mirë? Nuk e di, nuk jam takuar me atë njeri, por pasi që ai e përfaqëson një organizatë që quhet UE, e cila besoj që është e aftë të menaxhojë tërë këtë. Pra, unë mendoj se do të ishte një gabim trashanik ndërprerja e dialogut sepse ajo që është e kundërta e dialogut e dimë çka është e unë nuk jam në favor të kësaj.

**Azem Vllasi**: Të jem më preciz. Unë jam për ridefinim apo definim më komplet të pikënisjes, bazës për bisedime, nuk jam për ndërprerjen e dialogut. Ndoshta zonja është diplomate e madhe, por kur flasim për këshillat e përmendët rrugën “Knez Mihajlo”, ndoshta e di apo nuk e di se atje është selia e Akademisë serbe të shkencave dhe arteve, disa këshilla që kanë ardhur nga atje për disa çështje serbe, jo vetëm në Kosovë por edhe gjetiu, nuk kanë qenë të mirë. Kështu që nuk e di a e dini këtë apo e thatë vetëm ashtu për rrugën “Knez Mihajlo”. Kërkoj ndjesë.

**Adrijana**: Zoti Vllasi, nëse nuk e di, do ta dijë. Sa i përket dialogut, do ta përsëris edhe njëherë, ai është më shumë se i nevojshëm. Dialogu është mjeti i vetëm që të arrihet deri tek zgjidhja e duhur. A është ky dialog i mirë apo jo, a po sjell rezultate apo jo, do të shohim, ende është heret të bëjmë përfundime për këtë. Sido që të jetë, dialogu duhet të vazhdojë nëse mendojmë të lëvizim nga kjo pikë. Pa marr parasysh se çka do të ndodh me këtë dialog, unë ju siguroj që ekipi komunal përgatitor do të vazhdojë të punojë së bashku me komunitetin, do të kontaktojë direkt atë, do të dëgjojë me kujdes se çka komuniteti dëshiron, cilat janë problemet e tyre dhe do të shfrytëzojë të gjitha mënyrat e mundshme të zgjidh problemet e përditshme që i kanë qytetarët në veri të Kosovës. Mendoj se kjo është rruga e vetme dhe do ta them përsëri, ka hapësirë në veri për lloj tjetër dialogu, jo vetëm për këtë dialog që po ndodh midis Prishtinës dhe Beogradit, me të vërtetë është e domosdoshme të merret parasysh mendimi i qytetarëve të Mitrovicës veriore dhe të fillohet dialogu direkt me njerëzit që jetojnë në veri të Kosovës. Ju faleminderit.

**Moderatorja**:  Je faleminderit shumë. A ka më pyetje? Nëse nuk ka, unë do të’ju falënderohesha të gjithëve me përfundimin se dialogu megjithatë nuk ka alternativë, pa marr parasysh mendimet e ndryshme që i dëgjuam. Qe i mirë apo i keq, sigurisht është më i mirë se sa diçka tjetër. Ju faleminderit shumë edhe njëherë dhe iu dëshiroj të kaloni mirë pjesën e mbetur të ditës.